

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Muhamet Rexha dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit M. Z., nga Fushë Kosovë, të cilin e përfaqëson F. M., avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Limak Kosovo International Airport J.S.C, “Adem Jashari” Komuna Lipjan, të cilin e përfaqëson F. Gj., sipas autorizimit me shkrim, për shkak të kontestit të punës, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurit të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë CA.nr.3789/2015 datë 26.09.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 15 maj 2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurit, i paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë CA.nr.3789/2015 datë 26.09.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë CA.nr.3789/2015 datë 26.09.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.192/2014 datë 03.07.2015, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, dhe është anuluar njoftimi i të paditurës i datës 03.03.2014 për mos vazhdimin e kontratës së punës me përgjigjen e të paditurës të datës 20.03.2014, është obliguar e paditura që paditësin në afat prej 7 ditësh ta kthejë në punë dhe detyra të punës si operator i mirëmbajtjes së aeroportit , dhe t'i paguaj të ardhurat personale në shumë prej 10.241,55 €, për periudhën prej datës 04.04.2014 e deri më 30.06.2015, me kamatë

ligjore vjetore prej 8 %, duke filluar nga data 01.07.2015 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.159,22 €.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si i bazuar revizioni i të paditurës si dhe i njëjti aktgjykim dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të prishen, dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësi në përgjigje të revizionit konteston në tërësi thëniet e revizionit të paditurit, duke propozuar që revizioni i të paditurit të refuzohet në tërësi si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në pajtim me nenin 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Partneritetit Publiko Privat në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Kompanisë private “Limak”, ka lidhur kontratën e punës me tani Aeroportin Ndërkombëtar “Limak Kosova”, në kohëzgjatje prej 3 viteve, duke filluar prej datës 04.04.2011 e deri më datën 03.04.2014, në vendin e punës Mirëmbajtës i Operatorit të Aeroportit. Nuk është kontestues fakti se paditësi në këtë aeroport ka kryer punët e lartpërmendura duke filluar nga data 01.02.2004. Me njoftimin e të paditurës të datës 03.03.2014, domethënë 1 muaj para skadimit të kontratës së punës, paditësi është njoftuar se kontrata e punës nuk do t'i vazhdohet, në pajtim me politikat e bordit të drejtorëve për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore, andaj me ditën e skadimit të kësaj kontrate të punësimit paditësit do ti ndërpritet marrëdhënia e punës. Nuk është kontestues fakti se e paditura nuk ka zhvilluar ndonjë procedurë të brendshme për ndërprerjen e kontratës së punës, e me këtë edhe të marrëdhënies së punës së paditësit.

Në një gjendje faktike të vërtetuar kësisoj, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësit i është ndërprerë kontrata e punës në kundërshtim me nenin 10.5 të Ligjit të Punës pasi që paditësi në këtë vend pune ka përvojë më tepër se 10 vite, andaj sipas kësaj dispozite ligjore konsiderohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me kontratë në kohë të pacaktuar. Për këtë

arsye ka obliguar të paditurën që paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës, duke e detyruar të paditurin që t’ia kompensojë edhe të ardhurat personale prej ditës së mos vazhdimit të kontratës së punës, e në vazhdim, në tërësi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se është me pa ndikim fakti se me kontratën e punës , të fundit, paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, me kohë të caktuar për 3 vite, kështu që pretendimet e të paditurës në këtë drejtim i ka refuzuar si të pabazuara. Lartësinë e të ardhurave personale gjykata e ka vërtetuar në bazë të ekspertizës financiare, të ekspertit Ali Gashi nga Lipjani.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë. Për më tepër, ka shtuar edhe se duke marrë parasysh që ky vend i punës akoma ekziston, dhe që paditësi këto punë i ka kryer më tepër se 10 vite, kjo tregon se ky vend i punës është i karakterit të përhershëm, dhe se në njoftimin për mos vazhdimin e kontratës nuk janë dhënë argumente bindëse për mos vazhdim të kontratës së punës. Për këtë nuk është dorëzuar asnjë vendim nga i cili konkludohet se e paditura ka zhvilluar procedurë të caktuar për tepricë të punësuarve, e as që ka nxjerr program të përshtatshëm për këta punëtor.

Në një gjendje të këtillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadsisë së paditësit, pasi që aktgjykimet e tyre në këtë rast, nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK, kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Në këtë kontekst, u refuzuan si të pabazuara pretendimet e revizionit për shkelje thelbësore nga neni 182.2 pika n, të LPK, të cilat sipas revizionit qëndrojnë në atë se aktgjykimi i atakuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare, ndërsa arsyet e paraqitura janë kundërthënëse së bashku me arsyetimin në përgjithësi. Këto pretendime të revizionit janë të pabazuara për faktin se, në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë në këtë çështje juridike, të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit. Të dy gjykatat, arsyetimin për aprovim të kërkesëpadsisë , kryesisht e kanë bazuar në faktet se paditësi në këtë

aeroport, në vend të njëjtë pune, ka më tepër se 10 vite përvojë pune, i cili fakt nuk është kontestues , si dhe në atë se kurrfarë procedure nuk është zhvilluar kundër paditësit lidhur me mos vazhdimin e kësaj kontrate, dhe nuk është nxjerr ndonjë vendim nga ana e të paditurës e as që është zhvilluar procedurë për tepricën e punëtorëve për të cilën e paditura pretendon në revizion, e as që është nxjerr ndonjë program i përshtatshëm për këta punëtor.

Gjykata e revizionit refuzon si të pabazuar pretendimin e revizionit se prej momentit të nënshkrimit të marrëveshjes në mes të Qeverisë së Kosovës dhe të paditurit , paditësi nuk ka më tepër se 3 vite përvojë pune. Ky fakt është me pa ndikim, me rëndësi është që paditësi në të njëjtin vend pune punon më tepër se 10 vite, dhe kontrata e tij e punës konsiderohet në kuptim të nenit 10.5 të Ligjit të Punës , si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore, kështu që të njëjtit ka pasur mundësi që t'i ndërpritet marrëdhënia e punës vetëm nën kushtet e parapara në nenin 70 të këtij ligji, e kurrësi në bazë të nenit 67.1 dhe 3 të këtij ligji, ku thuhet se kontrata e punës sipas fuqisë ligjore , ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së punës. Në rastin konkret me njoftim , ashtu siç ka vepruar e paditura , nuk ka pas mundësi që paditësit mos t'i vazhdohet kontrata e punës kur ligjërisht kontrata e tij e punës konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Gjykata e revizionit vlerësoi edhe pretendimet e revizionit përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, të cilat sipas revizionit qëndrojnë në atë se aprovimi i kërkesëpadisë së paditësit për kthim në punë është në kundërshtim me nenin 9.18 të Marrëveshjes së lartpërmendur të lidhur në mes Qeverisë së Kosovës dhe të paditurit. Në këtë dispozitë të kësaj marrëveshjeje, parashihet që partneri privat (këtu i padituri), mund të përfundojë punësimin ose ndonjë angazhim të çfarëdo punëtori të ANP në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuara sipas marrëveshjes së përbashkët dhe pa kufizime pas përvjetorit të tretë të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Nga kjo dispozitë rezulton se nuk parashihet ndërprerja e kontratave të ngjashme të punësimit sikur tek rasti i paditësit , në kundërshtim me ligjet ekzistuese në Kosovë.

Përkitazi me lartësinë e të ardhurave personale në revizionin e të paditurës nuk ka kundërshtime, mirëpo, në këtë pjesë gjykata e revizionit, në kuptim të nenit 215 të LPK sipas detyrës zyrtare shqyrtoi zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, dhe me këtë rast gjeti se fitimi i humbur në formë të humbjes së të ardhurave personale, është konstatuar në bazë të ekspertizës

financiare, e cila nuk është kundërshtuar nga ana e të paditurit, kështu që në pajtim me nenin 136.1, 173 dhe 174 të LMD në fuqi, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësit edhe për kompensimin e të ardhurave personale të humbura për shkak të ndërprerjes së pa ligjshme të marrëdhënies së punës së paditësit.

Për arsyet e paraqitura më lart, dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.97/2017 datë 15 maj 2017

Kryetar i kolegjit,
Shukri Sylejmani